

PËRSHKRIMI

FREEZETECH 100 është një përbërës betoni që përbëhet nga komponime kimike pa klorure, shkurtonë kohën e lidhjes dhe kohën e ngurtësimit të betonit të njomë. Me këtë veçori, ai ofron mundësinë për formim të hershëm duke rritur forcën në shtypje fillestare pa zvogëluar punueshmërinë dhe forcën në shtypje të betonit në të gjitha kushtet e mjedisit, veçanërisht në kushtet e motit të ftohtë dhe minimizon rrezikun e ekspozimit të betonit ndaj ngricave.

FUSHA E APLIKIMIT

- Në të gjitha klasat e përshkruara të betonit të gatshëm në EN 206 dhe EN 13515.
- Në aplikacione të betonit në mot të ftohtë.
- Betonet që kanë nevojë për formimin e hershëm.
- Aritja e forcës së lartë në kohë të hershme.

KARAKTERISTIKAT

- Siguron lidhjen e hershme duke rritur temperaturën e hidratimit të betonit.
- Ndihmon në mbrojtjen e betonit nga ngricat duke zvogëluar pikën e ngrirjes e ujit në beton.
- Nuk përmban klorure. Nuk shkakton korrodime për armaturë.
- Rrit forcën e hershme të betonit.

PËRDORIMI

FREEZETECH 100, mund të përdoret për hedhjen e betonit deri në + 5°C. Për derdhjen e betonit nën këtë temperaturë duhet të mirren masa shtesë mbrojtëse si (izolimi i kallëpeve, mbulesë mbrojtëse, etj.)

FREEZETECH 100 për beton të njomë përdoret në gjendje të lëngët. Preferohet të shtohet në ujë gjatë përzierjes së betonit.

STANDARTET

- FreezeTech 100: EN 934-2 tabela 6 3.2 ASTM C 494 Tip C

SASIA E PËRDORIMIT

Sipas standardeve EN 206 ve EN 13515 rekomadohet përdorimi 0.5% deri në 3.0% ndaj peshës së përgjithshme në receptur të lidhësit (çimentos).

KUSHTET E RUAJTJES DHE PAKETIMI

Produkti duhet të ruhet mbi -10°C. Nëse produkti ngrihet, duhet të përzihet mekanikisht pas shkrijës.

Shitet në sasi prej 1100kg

PËRPUTHSHMËRIA

FREEZETECH 100 është i përputhshëm me, ExtraTech, HyperTech, SuperTech, AirTech, ProofTech. Ju lutemi të kontaktoni mbështetjen teknike të TechnoChem për pajtueshmërinë me kontribute të tjera. Nëse më shumë se një shtesë (aditiv) duhet të përdoret në recepturën e dëshiruar, secila shtesë duhet të shtohet në përzierje veç e veç.

FREEZETECH 100, Mund të përdoret me të gjitha llojet e çimentos që përputhen me standardin EN 197-1. Rekomandohet të kontaktoni njësinë mbështetëse teknike TechnoChem për përdorim në lloje të veçanta të çimentos.

INFORMACION MBI SIGURINË

Kontaktet e lëkurës dhe syve me adetivin duhet të parandalohen, në rast kontakti lani me shumë ujë. Në rast të kontaktit me sytë, shpërlajeni menjëherë me shumë ujë dhe kërkoni këshilla mjekësore.

Për informacion të mëtejshëm ju lutemi referojuni fletës së të dhënave për sigurinë e materialit (MSDS) të produktit.